



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 shkurt 2012
Nr. ref.: RK 200/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI

në

Rastin nr. KI 107/11

Parashtruesi

Hamzi Bylykbashi

e të tjerët

Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e Kërkesës

1. **Parashtrues të kërkesës janë:** Hamzi Bylykbashi, Ferat Kuqi, Nasibe Llapatinca, Sadri Abazi, Abaz Demiri, Shaban Basha, Tahir Gashi, Asbije Gashi, Sali Bytyqi, Hajrije Sallani, Gani Musliu, Xhemali Jahaj, Halil Durmishi, Igballe Koigeci, Hamdi Palushi, Baftijar Hoxha, Shaban Tahiri, Mahmut Kadolli, Hysen Muqaj, Haki Baraliu, Hazir Bytyqi, Sinan Hajdari, Ramadan Sallahu, Ibrahim Berisha, Sahit Basha, Ismet Vranovci, Shefka Avdija, Sali Morina, Mexhit Baraliu, Xhemajl Kuqi, Mahmut Alijaj, Zenel Krasniqi, dhe Aziz Bukoshi, te gjithë ish punetore te K.K. Suhareke te cilët me autorizim i përfaqëson Ethem Rogova, avokat . nga Prizreni

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Kosovës është Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, **Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011** të cilin përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës sipas kopjes së nënshkruar të fletëkthesës së Gjykatës Komonale në Suharekë e cila ka bërë dorëzimin e tij ,**e ka pranuar më 01.04,2011.**

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së regjistruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës me date 08. Gusht 2011 është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011 Me të cilin kjo gjykatë kishte refuzuar propozimin e përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës drejtuar kësaj Gjykate për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Suharekë C.nr.423/2004 të datës 23.11.2004 e të ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr.31/2007 të datës 14.06.2007.

Baza juridike

4. Neni 113.7 Kushtetutës së Republikës së Kosovës(në te tekstin e mëtejme Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i dt. 16 Dhjetor 2009 i hyrë në fuqi me 15 janar 2010(në tekstin e mëtejme referuar si Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme i referuar si rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtuese

5. Më 15. korrik 2011 Gjykata Kushtuese pranoi nëpërmes postës një shkresë të cilës i ishin bashkangjitur edhe vendimet a autoriteteve publike që kontestoheshin ,e me anë të së cilës kërkohet që Gjykata Kushtetuese të vlerësoj kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011 të Gjykatës së Qarkut në Prizren

6. Më 22 korrik Gjykata Kushtetuese i dërgoj një njoftim përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesve të kërkesës avokatit z. Ethem Rugova me anë të cilit Gjykata kërkoj që në aftin e dhënë në njoftim të plotësoj kërkesën duke plotësuar edhe formularin zyrtar për dorëzimin e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese.
7. Më 28 korrik 2011 ,brenda afatit të dhënë nga Gjykata,zRugova i dërgoj përgjigjeje Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën e bërë dhe kërkoj sqarime shtesë se ku mund ta marrë formularin zyrtar.
8. Më 4 gusht 2011 Gjykata Kushtetuese kishte pranuar nëpërmes postës kërkesën e përsëritur nga Avokati Ethem Rugova kësaj radhe edhe me formularin zyrtar të plotësuar dhe të gjitha kopjet e vendimeve të autoriteteve publike të cilat kanë të bëjnë me rastin.
9. Më 8 gusht 2011 kërkesa e z. Parashtruesve i u regjistrua në Departamentin përkatës të Gjykatës Kushtetuese dhe mori numrin KI 107/11
10. Më 8 gusht 2011 pra të njëjtën ditë Gjykata Kushtetuese dërgoj njoftimin për regjistrimin e kërkesës palëve të përfshira në lëndë dhe njëkohësisht nga përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës kërkoj që kërkesën ta plotësoj me autorizimin me shkrim për përfaqësim dhe kopjet e lejeve të njoftimit për personat që përfaqësohen.
11. Më 22 gusht 2011 Gjykata Kushtetuese pranoi nga avokati Rugova dokumentacionin plotësues të kërkuar.
12. Më 23 gusht Kryetari i Gjykatës me vendimin Gjr,KI 107/11 caktoj gjyqtarin Robert Carolan i cili do të përpiloj raportin paraprak lidhur me kërkesën.
13. Të njëjtën ditë Kryetrari i Gjykatës me vendimin KSH-KI 107/11, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje Ivan Cukalovic(kryesues) dhe gjyqtarët Mr.sc.Kadri Kryeziu e Prof.Dr.Enver Hasani, në cilësi të anëtarëve të kolegjit
14. Më 17 nëntor Gjykata Kushtetuese kishte pranuar nëpërmes faksit zyrtar nga Gjykata Komunale në Suharekë kopjen e fletëdorzimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011 nga i cili vërtetohej se z.Hamzi Bylykbashi i pari nga lista e ankuesve i cili ka edhe autorizim për përfaqësim nga kolegët e tij ,këtë vendim e ka pranuar më 01.042011.

Përmbledhja e fakteve

15. Në vitin 2001(data e pa specifikuar) Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Suharekës ka bërë publike qarkoren të cilën ua ka drejtuar të gjithë të punësuarve në shërbimin civil komunal(administrata komunale)në formë të ofertës për pensionim vullnetar të gjithë atyre që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me qarkore e që janë mosha së paku 45 vjeçare dhe së paku 15 vjet shërbimi (përvojë pune).Pensioni vullnetar do të kompensohej me mjete materiale në shumën prej një rroge mujore për secilin vit shërbimi dhe nuk do të kalonte shumën e përgjithshme prej 8000 DM.

16. Në qarkore specifikohet se kjo ofertë bëhet me qëllim të ofrimit të një pako ndihme materiale për ata që do të largohen nga puna në Komunë, sepse në bazë të rekomandimit të Komisionit për reformën e administratës publike si dhe vendimit të Asamblesë Komunale të Suharekës “numri i punëtorëve në Administratën Komunale duhet të zvogëlohet”. Ndërsa aplikimi për pensionin e ofruar është në baza vullnetare.
17. Pas afatit të lënë sipas qarkores, kësaj ofertë të Kryeshëfit ekzekutiv i janë përgjigjur një numër i madh i të punësuarve që i plotësonin kushtet e kërkuara ndërsa komuna iu ka zgjedhur zyrtarisht “ për pensionin vullnetar” 33 aplikuesit më të denjë e që tani janë parashtrues të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
18. Sipas dokumentacionit të paraqitur në lëndë të gjithë punëtorët të cilëve u është njohur e drejta për pension vullnetar kanë **marrë Aktvendimet me shkrim për shkëputjen e marrëdhënies së punës me marrëveshje** në të cilat janë specifikuar edhe data e shkëputjes së marrëdhënies së Punës edhe Kompensimi material që ju takon. Të gjithë të punësuarit i kishin pranuar këtë aktvendime dhe i kishin nënshkruar ato, ndërsa në cilësi të provës së bashku me kërkesën në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur edhe Aktvendimi (si në kopje që i kishin edhe të tjerët) 02.nr 334 i dt.30.07.2001 për punëtorin z.Sadri Abazi në të cilin ishte dhënë edhe dhe këshilla juridike që pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
19. Më 22.12.2003 Gjykata Komunale në Suharekë duke vepruar sipas ankesës së 33 ish punëtorëve të administratës Komunale të Komunës së Suharekës ka nxjerrë Aktgjykimin C.nr.159/03 me të cilin ka Refuzuar kërkesëpadinë e paditësve në tërësi **si të pabazuar**, dhe në arsyetimin e këtij Aktgjykimi thuhet se jo bazushmëria e tij mbështetet në faktin se të gjithë punëtorët kanë nënshkruar Aktvendimet për shkëputjen e marrëdhënies së punës me marrëveshje, se kanë marrë kompensimin sipas aktvendimeve dhe se edhe pse kanë pasur në dispozicion mjetin juridik të ankesës atë nuk e kanë shfrytëzuar andaj këto aktvendime janë të plotfuqishme.
20. Kundër këtij Aktgjykimi në afat ligjor i autorizuari i paditësve ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
21. Më 23.06.2004 Gjykata e Qarkut në Prizren ka nxjerrë Aktgjykimin Ac.42/2004 me anë të së cilit është **Aprovuar** ankesa e të autorizuarit të paditësve (Hamzi Bylykbashi dhe 32 të tjerë), është prishur Aktgjykimi C.nr.159/03 i datës 22.12.2003 dhe lënda i është kthyer Gjykatës Komunale në Suharekë për rivendosje. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet se Gjykata e shkallës së parë Aktgjykimin e vet e ka bazuar në përcaktimin e gjendjes faktike të gabuar dhe jo të plotë si dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale andaj domosdo është dashur të prishet nga gjykata e shkallës së dytë
22. Më 23.11.2004 Gjykata Komunale në Suharekë, duke marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në procedurën e përsëritur ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr.423/04 dhe ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve njëkohësisht ka anuluar të gjitha aktvendimet për shkëputjen e marrëdhënies së punës sipas marrëveshjes, duke obliguar të paditurën Komunën e Suharekës që paditësit në afat prej 15 ditësh të kthejë në vendet e tyre të punës apo në një vend të punës sipas kualifikimeve që posedojnë.
23. Kundër këtij Aktgjykimi Komuna e Suharekës ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

24. Më 10.11.2006 Gjykata e Qarkut në Prizren ka nxjerrë Aktgjykimin Ac.nr 30/2005 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës –Komuna e Prizrenit dhe ka **Vërtetuar** A aktgjykimin C.nr.423/2004 të datës 23.11.2004,të Gjykatës Komunale në Suharekë duke konstatuar se Aktgjykimi i Shkallës së parë ka vërtetuar plotësisht drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe ka aplikuar drejt dispozitat materiale.
25. Kundër këtij Aktgjykimi ,Komuna e Suharekës ka paraqitur kërkesë për Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
26. Më 14.06.2007 ,Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin rev.nr 31/2007 me të cilin ka PRANUAR revizionin e të Paditurës –Komuna e Suharekës dhe ka **ndryshuar** ,Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.30/2005 ,dt.10.11.2006 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.423/2004 .dt.23.11.2004 në mënyrë që padia e paditësve në këtë çështje juridike HIDHET POSHTË si e **pakohshme**.
27. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi Gjykata Supreme ka theksuar se gjykatat e instancave më të ulëta “Mbi gjendjen faktike të konstatuar drejt dhe në mënyrë të plotë ,gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kurë kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar për të cilën arsye u desh që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që padia e paditësve të hidhet si e pakohshme”
28. Gjykata Supreme më tej në arsyetimin e Aktgjykimit rev.nr 31/2007 përcakton se Aktgjykimi i saj bazohet në faktin se në ligjin e aplikueshëm në kohën kurë ka ndodhur kontesti(ligji mbi Administratën Shtetërore i Kosovës gaz,zyr 30/80)kishte paraparë me nenin 213 se afati për ankim në organin e shkallës së dytë është 15 ditë nga dita e marrjes së Aktvendimit dhe se pas marrjes së vendimit nga shkalla e dytë pala edhe më tej e pakënaqur në afat prej 30 ditësh ka të drejtë të i drejtohet gjykatës kompetente,ndërsa gjykata Supreme citon gjithashtu edhe Ligjin themelor për Marrëdhëniet te punës ,gjithashtu ligj i aplikueshëm në Kosovë i cili në nenin 83.par.2 kishte paraparë se “mbrojtja gjyqësore para gjykatës nuk mund të kërkohej nëqofëse punëtori paraprakisht nuk ka kërkuar mbrojtje para organit kompetent të punëdhënësit” andaj duke marrë parasysh fatin se punëtorët e Komunës s Suharekës nuk e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë edhe padia e tyre është e pakohshme.
29. Gjykata supreme gjithashtu ka theksuar se”objekt shqyrtimi në këtë kontest është ligjshmëria e aktvendimeve të së paditurës me të cilat paditësve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës ,kundër të cilave paditësit nuk kanë kërkuar mbrojtje juridike sipas dispozitave ligjore të sipërpërmendura ,andaj gjykatat e shkallëve më të ulëta gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë aprovuar padinë duke konstatuar se paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë çështjet e pensionimit e në fakt aktvendimet e të paditurës nuk kanë të bëjnë me e pensionimin e paditësve por me shkëputjen e marrëdhënies së punës sipas marrëveshjes”(shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme rev . nr 31/2007 të datës 14 06 2007 faqe 3).
30. Ta pakënaqur me këtë Aktgjykim parashtruesit e kërkesës nëpërmes të autorizuarit të tyre avokatit Ethem Rugova kanë paraqitur **Kërkesë për përsëritjen e procedurës** në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
31. Më 21.03.2011 Gjykata e Qarkut në Prizren ka nxjerrë Aktvendimin Ac.nr.293/2010 me të cilin ka refuzuar kërkesën për përsëritjen e procedurës të përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.423/2004 të datës 23.11.2004 i

ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.31/2007 të datës 14.06.2007,duke konstatuar se nuk ekzistojnë fakte që do t ë justifikonin përsëritjen e procedurës .

Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara Kushtetuese

32. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim:neni 49(e drejta e punës dhe zgjedhja e profesionit)neni 41 i Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut. (shpërblimi i drejtë)

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Për te qene ne gjendje për te gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit te kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht te vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë te cilat përcaktohen ne Kushtetute,ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës

34. Ne lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 te Kushtetutës qe përcakton se:

*"Individët janë te autorizuar te ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike te drejtave dhe lirive te tyre individuale, te garantuara me Kushtetute, mirëpo vetëm pasi te kenë shteruar te gjitha mjetet juridike te përcaktuara me ligj."***

Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ku shprehimisht përcaktohet se:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi."

dhe

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar:

35. Duke iu referuar shkeljes së supozuar të së drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të Konventave e instrumenteve tjera Ndërkombëtare nga ana e parashtruesit të Kërkesës Gjykata Kushtetuese konstaton:

36. I autorizuari i parashtruesve të kërkesës nëpërmes postës, Gjykatës Kushtetuese i kishte dërguar me postë më 15.07.2011 një kërkesë të shkruar të cilës i kishte bashkangjitur edhe të gjitha Aktgjykimet dhe Aktvendimet e nevojshme ,ndërsa pas kërkesës së Gjykatës në afatin e dhënë nga Gjykata kishte plotësuar edhe lëndën me

formën standarde të kërkesës ,andaj Gjykata konsideron se data e komunizmit të parë me Gjykatën 15.07.2011 e bënë kërkesën të pranueshme sa i përket afatit edhe pse ajo në Gjykatë si e plotë është regjistruar me 08 gusht 2011.

37. Në lidhje me këtë Gjykata Kushtetuese i referohet edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ ku në rastin Kemevuako v. Holandë (Aplikacioni Nr.65938/09 1 qershor 2010) kishte theksuar se” duhet si rregull i përgjithshëm të konsiderohet që të jetë datë e paraqitjes së një kërkesë data e parë e komunikimit me Gjykatën nga aplikuesi- madje edhe atëherë kur objekti i çështjes është shpjeguar shkurtimisht , me kusht që një formë krejtësisht e plotësuar aplikimi është paraqitur brenda afatit të caktuar nga Gjykata .
38. Gjykata gjithmonë ka parasysh faktin se qëllimi i rregullit katër-mujor është për të promovuar sigurinë juridike,të sigurojë që rastet e ngritura për e çështjet Kushtetuese do të ë shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme dhe për të mbrojtur autoritetet dhe personat e tjerë të interesuar nga të qenit në një situatë të pasigurisë për një periudhë të gjatë kohore (shih mutatis mutandis PM v Mbretëria e Bashkuar Aplikacioni no. 6638/03 , 19 korrik 2005)
39. Parashtruesit e kërkesës kishin pretenduar se atyre iu është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë sipas nenit 49 të Kushtetutës ,për punë dhe zgjedhje të profesionit.
40. Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta për punë dhe zgjedhje të profesionit është e drejtë e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 49) që para së gjithash nënkupton se secili individ ka të drejtë për punë dhe zgjedhje të profesionit në liri të plotë dhe nën kushtet e njëjta me të gjithë qytetarët e tjerë dhe vëren se e drejta për punë rregullohet me ligjet përkatëse të lëmisë së punës,
- 41 Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve ,dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe e të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta si në rastin konkret i Gjykatës Supreme duke Aprovuar revizionin e e të paditurës apo të Gjykatës së Qarkut duke refuzuar kërkesën për përsëritje të procedurës nga ana e paditësve, dhe se roli i sajë (i GJ.Kushtuese)është vetëm qe ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat qe garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veproje si "gjykate e shkalës së katërt", (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kunder Turqise, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65
42. Fakti i thjeshte se parashtruesit janë te pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund tu shërbejë atyre si e drejtë te ngrënë një kërkesë te argumentueshme për shkelje te Nenit 31 te Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kunder Hungarise, Aktgjykim i 26 korrikut 2005 ose , Tengerakis v. Qipro, nr. 35698/03, vendim i datës 9 nëntor 2006, § 74).
43. Në këtë rast, parashtruesit e kërkesës dështuan në kohën e duhur për të shter të gjitha mjetet e tyre ligjore, siç përshkruhet në paragrafin 28 të këtij aktvendimi . Për këtë kjo Gjykatë që tani të veprojë në lidhje me kërkesën e tyre, do të duhet të injorojë faktin se parashtruesit e kërkesës kanë dështuar për të vepruar në një kohë të caktuar dhe për të shter të gjitha mjetet e tyre ligjore. Kjo gjykatë nuk ka atë autoritet. Kjo gjykatë nuk mund të veprojë si një gjykatë e shkallës së katërt duke zëvendësuar

vendimin e Gjykatave sa i përket fakteve (ose të ligjit në fuqi për atë janë gjykatat e rregullta.)

44. Për të deklaruar një Aktgjykim apo Aktvendim të një autoriteti publik si jo kushtetues parashtruesi i kërkesës do të duhej prima facie të tregojë se” Vendimi i autoritetit publik, si e tillë, do të jetë tregues i një shkeljeje të kërkesës gjykim të drejtë, dhe nëse, pa arsyeshmëria e atij vendimi është aq e dukshme sa që vendimi mund të konsiderohet si vendim **tej mase arbitrare** (shih GjEDNj, *Khamidov kundër Rusisë*, nr. 72118/01, aktgjykimi i datës 15 nëntor 2007, § 175.
45. Gjykata Kushtetuese nga në Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut **Ac.nr.293/2010** të datës **21.3.2011** nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të drejtave të njeriut sikur që parashtruesit e kërkesës kishin pretenduar.
46. Në këto rrethana parashtruesi ankesës nuk ka “argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij” dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar andaj, Gjykata në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika c dhe d , gjen se kërkesën duhet ta refuzoj si qartas të pabazuar., dhe rrjedhimisht

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 5 tetorit 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani